



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1701/2 Prot.

Laç, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 21 datë 24/03/2023

**“PËR DHËNIEN E NJË GJYSËM BURSE NJË NXËNËSI TË ARSIMIT BAZË PËR
VITIN MËSIMOR 2022 – 2023”**

Bazuar në ligjin Nr. 139/15, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, shkresën Nr. 6478/54 Prot., datë 11.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2022-2023”, 30 (tridhjetë) bursa, referuar shkresës Nr. 231 Prot., datë 17.03.2023, pika 2, të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin “Për disa ndyshime në shkresën Nr. 1215 Prot. datë 16.12.2022 “Kërkesë për mbështetje financiare”, për arsye largimi jashtë shtetit të nxënësit Alion Shkëlzen Hyseni, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot, i cili ka përfituar burse me vendimin nr.168 është menduar që fondi i kësaj burse të kalojë tek nxënësi Mikel Gjini Gjoka, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot, Pas propozimit nga ZVAP, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

Të miratojë dhëniën e një gjysëm burse, nxënësit _____, shkolla 9-vjeçare “28 Nëntori” Fushë Milot .

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

- **Prefektit të Qarkut Lezhë**
- **ZVAP Kurbin**
- **Drejtorisë së Arsimit Kulturës Rinisë dhe Sporteve**
- **Arkivit**

SEKRETAR I I KËSHILLIT

Arbër LEKA

KRYETARI I KËSHILLIT

Edlira LLESHI